



---

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

**R A P O R T**

**PËR VETEVALLUIMIN E**

**FAKULTETIT JURIDIK**

**PËR VITET AKADEMIKE**

**2019/2020; 2020/2021; 2021/2022**

Fakulteti Juridik-Правен факултет-Faculty of Law  
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia  
[www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) – e-mail: [law@unite.edu.mk](mailto:law@unite.edu.mk)

# PËRMBAJTJA

|                                                                   |           |
|-------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT .....</b>                | <b>3</b>  |
| <b>2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT .....</b>                           | <b>4</b>  |
| 2.1. Historiku.....                                               | 4         |
| 2.2. Misioni .....                                                | 5         |
| 2.3. Strategjitë e zhvillimit .....                               | 5         |
| <b>3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT .....</b>               | <b>10</b> |
| 3.1. Organogrami.....                                             | 10        |
| 3.2. Programet studimore në Fakultetin Juridik .....              | 10        |
| <b>4. VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE.....</b>                     | <b>13</b> |
| 4.1.Struktura e kuadrit mësimor–shkencor.....                     | 15        |
| <b>5. STRUKTURA E STUDENTËVE .....</b>                            | <b>17</b> |
| 5.1.Struktura e studentëve në studimet deridiplomike .....        | 17        |
| 5.2.Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike .....         | 19        |
| 5.3.Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës .....       | 21        |
| 5.4.Studimet e disperzuara .....                                  | 21        |
| <b>6. ANKETIMI I STUDENTËVE .....</b>                             | <b>23</b> |
| <b>7. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE .....</b> | <b>26</b> |
| <b>8. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE .....</b>                  | <b>29</b> |
| <b>9. KONKLUDIMI .....</b>                                        | <b>32</b> |

# 1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT

Çështja e realizimit të evaluimit paraqet një dukuri mjaft me peshë në kuadër të aspektit të avancimit të procesit edukativ-arsimor. Bazuar në aktet juridike në fuqi, të cilat rregullojnë sferën e arsimit të lartë, evaluimi paraqet obligim ligjor të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Evaluimi i brendshëm i Fakultetit Juridik për vitin akademik 2016 është realizuar gjatë muajit maj të vitit 2016. Qëllimi i vetevaluimit ishte të identifikohet gjendja momentale e Fakultetit Juridik dhe përfundimet nga i njëjti të shërbejnë si bazë e mbindërtimit të kualitetit të procesit mësimor-shkencor. Evaluimi i brendshëm u realizua nga Komisioni për vetevaluim i Fakultetit Juridik. Gjatë këtij procesi është realizuar evaluim i kuadrit mësimor në të gjitha programet studimore të Fakultetit, përfshirë Studimet e Drejtësisë, Gazetarisë, Shkencave Politike dhe studimeve të Kriminalistikës.

Në proces të evaluimit u përfshinë: vlerësimi i programeve studimore ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore; struktura e kuadrit mësimor – shkencor, përshkrimi i realizimit të mësimdhënies, vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor, struktura e studentëve, anketimi i studentëve që vlerësojnë përmes disa komponentëve, struktura e kuadrit administrativ dhe teknik, hapësirat dhe mjetet e realizimit të procesit mësimor. Evaluimi është realizuar nga komisioni përkatës i themeluar me Vendim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik dhe me miratim të Këshillit të Rektoratit të USHT-së. Ky proces ka përfshirë Fakultetin Juridik në Tetovë si dhe programet: Gazetari, Shkenca Politike dhe Studimet e Kriminalistikës.

Raporti për vetevaluim të Fakultetit Juridik është realizuar edhe në studimet e disperzuara të programeve studimore të gazetarisë në Shkup dhe studimet e disperzuara të drejtësisë në Kërçovë. Materialet për realizimin praktik të tij janë përgatitur nga Komisioni qendror për evaluim në kuadër të USHT-së. Gjatë realizimit të tij nuk kemi hasur në vështirësi të caktuara, por përkundrazi bashkëpunimi mes anëtarëve të Komisionit, administratës, dekanatit të Fakultetit Juridik dhe studentëve ka qenë në nivelin e duhur.

Pas përfundimit të procesit të evaluimit, komisioni ka dërguar në mënyrë individuale analizat që janë nxjerrë nga ky proces dhe i janë dërguar stafit të Fakultetit. Nga kjo të gjithë

profesorët janë njoftuar me rezultatet e evaluimit dhe qëndrimet e studentëve lidhur me lëndën, procesin e mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, vlerësimeve gjatë procesit të notimit etj.

Nga ky raport që është dërguar te profesorët e Fakultetit Juridik, stafi ka mundur që në mënyrë të drejtpërdrejtë të njihet me qëndrimet e studentëve lidhur me anët pozitive dhe anët negative të cilat kanë qenë evidente gjatë realizimit të ligjëratave. Procesi i evaluimit, përveç se konstaton gjendjen faktike të Fakultetit lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien, gjithashtu mundëson që në kohë të vërehen anomalitë dhe defektet dhe në kohë të eliminohen të njëjtat.

## **2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT**

### **2.1. Historiku**

Fakulteti Juridik është themeluar si njësi e Universitetit të Tetovës më 17 dhjetor 1994, me iniciativën e intelektualëve shqiptarë, të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike, arsimore dhe të gjithë dashamirëve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Zhvillimi i Universitetit të Tetovës ndahet në dy periudha:

- 1994-2003 koha historike e krijimit të tij; dhe
- Nga viti 2004 është periudha e zhvillimit institucional dhe koha e modernizimit akademik.

Nga viti 1994 deri në vitin 2004 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës funksiononte vetëm programi studimor Juridik, si studime katërvjeçare si dhe me plan-program të harmonizuar me fakultetet e drejtësisë të universiteteve të rajonit. Ndërsa, nga muaji janar i vitit 2004 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u miratua Ligj i veçantë për themelimin e Universitetit të Tetovës, prej nga edhe e fitoi statusin e institucionit të lartë publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me seli në Tetovë, me pesë fakultete, mes të cilëve ishte edhe Fakulteti Juridik. Deri në vitin 2007, në Fakultetin Juridik vazhduan studimet e drejtësisë së përgjithshme, me kohëzgjatje katërvjeçare.

Me akreditimin e vitit 2007/2008, në kuadër të Fakultetit Juridik, janë themeluar edhe dy programe studimore, programi studimor i Gazetarisë dhe Shkencave Politike, me kohëzgjatje të studimeve katër vjet. Programi studimor i Shkencave Politike në kuadër të Fakultetit Juridik filloi me punë në qytetin e Shkupit, ndërsa programi studimor i Gazetarisë në Tetovë dhe i njëjti hapi edhe disperzime në qytetin e Shkupit. Po ashtu gjatë vitit 2007/2008 filloi edhe implementimi i Sistemit të Bolonjës e më këtë edhe programi studimor i drejtësisë pësoi ndryshim, me ç'rast tani më studimet e drejtësisë prej katërvjeçare u shndërruan në studimet trevjeçare me 180 kredi. Në vitin 2014 në kuadër të Fakultetit Juridik u themelua edhe programi studimor i Kriminalistikës.

Fakulteti Juridik është institucion publik i shkollimit të lartë dhe si i tillë është i hapur dhe i arritshëm për të gjithë ata të cilët si studentë, mësimdhënës, bashkëpunëtorë, me cilësitë e veta intelektuale dhe morale në ambientin e definuar të autonomisë universitare, të dëshmimit të aftësive dhe cilësive, japin kontributin e vet në sferën e zhvillimit të arsimit, shkencës dhe profesionalizimit.

## **2.2. Misioni**

Misioni i Fakultetit Juridik përfshin tendencën e krijimit të kuadrove të profesionalizuara në sferën e së drejtës, shkencave politike, gazetarisë dhe kriminalistikës. Konkretisht, qëllimi kryesor i Fakultetit është që të përgatitë kuadro të reja me kapacitet të lartë profesional, të cilët do të mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e sistemit juridik, shoqëror, si gjykata, qeveri, ministri, kuvend, komuna, drejtori, mediat e shkruara dhe audio-vizuele, agjencione të ndryshme, veprimtari në sferën e jurisprudence, avokatisë, noterisë dhe sfera të tjera të sektorit privat.

## **2.3. Strategjitë e zhvillimit**

Gjatë kësaj periudhe nga viti akademik 2016-17 Fakulteti Juridik ka realizuar planet dhe strategjitë që i ka paraparë përgjatë vitit akademik. Si aktivitete më të rëndësishme janë këto:

- Realizimi i plotë dhe përcjellja me përpikëri e mbarëvajtjes së ligjëratave dhe ushtrimeve në Fakultetin Juridik, si dhe në programet studimore brenda tij, si një nga kushtet dhe obligimet themelore pedagogjike që burojnë nga Ligji i arsimit të lartë në RVM;
- Krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i mëtutjeshëm i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore, që do zhvillohet më tej në Fakultetin Juridik dhe në programet studimore brenda këtij Fakulteti;
- Vijimi i realizimit të plotë të mësimit praktik, duke përmbushur planin aksional, që është hartuar në fakultet për dërgimin e studentëve në institucionet përkatëse shtetërore përfshirë gjykata, prokurori, noterë, avokatë, organe të administratës shtetërore të pushtetit qendror dhe atij lokal, mediat e vendit dhe ato të Shqipërisë e Kosovës me qëllim të zbatimit të mësimit teorik në praktikë;
- Vazhdimi i mbajtjes së mësimit klinik me persona zyrtarë së paku nga 10 vjet përvojë pune nga institucionet përkatëse të Republikës së Maqedonisë, me qëllim të aftësimit të studentëve në përpilimin dhe hartimin e akteve të ndryshme juridike në praktikë;
- Mbajtja e konferencës në bashkëpunim me Aleancën Franceze në Tetovë, më 29.02.2016;
- Organizimi i një seminari me temë: "Korniza normative dhe udhëzimet për monitorimin e gjuhës së urrejtjes" për studentët e ciklit të parë dhe të dytë më datë 07-08 prill 2016;
- Vizitë studimore për qasjen dhe përpunimin e të dhënave për veprat penale dhe diskriminimin, të shkaktuar nga urrejtja në Gjykatën Themelore në Tetovë dhe sektorin për punë të brendshme në Tetovë për studentët e ciklit të parë dhe të dytë më datë 28 - 29 prill 2016;
- Organizimi i debateve dhe fokus-grupeve me studentët e studimeve të ciklit të parë për temën "Mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi" në Tetovë, Shkup dhe Kërçovë më datë 03-14 maj 2016;
- Organizimi i shkollës verore "Të drejtat e njeriut dhe drejtësia penale", Ohër më datë 21-30 korrik 2016;

- Organizimi i Kongresit (Konferencës) të Studentëve të Drejtësisë: "Drejtësia, barazia dhe mosdiskriminimi", për studentët e ciklit të parë dhe të dytë, më datë 30 shtator 2016;
- Organizimi i Konferencës së Tretë Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Juridik më datë 13 - 14 nëntor 2016;
- Pjesëmarrje në aktivitetet për improvizim të seancave gjyqësore nga fusha e drejtësisë penale të organizuara në partneritet me fakultetet juridike të vendit;
- Vazhdimi i organizimit të aktiviteteve me karakter profesional dhe shkencor me Aleancën Franceze dhe Institutin Francez për të drejtat e njeriut;
- Pjesëmarrja dhe intensifikimi i bashkëpunimit në fushën shkencore me institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare;
- Botimi i nr. 4 dhe 5/6 i revistës shkencore ndërkombëtare "Justicia";
- Kemi konkurruar me disa projekte të karakterit hulumtues shkencor, në fushën e mësimdhënies në institucionet përkatëse për të fituar grante të caktuara, së bashku me disa partnerë të universiteteve nga rajoni dhe Evropa që do të ndihmonin stafin e fakultetit tonë në aftësimin e mëtejshëm të tij në të arriturat e fundit të mësimdhënies dhe me kërkime të ndryshme shkencore. Ne si fakultet, në bashkëpunim me Zyrën për shkencë kemi hartuar projekte me interes për Fakultetin përkatësisht për Universitetin tonë;
- Organizimi i manifestimit të 9 Majit - Ditës së Evropës në nivel të Universitetit;
- Organizimi i disa tryezave shkencore me pjesëmarrës të ndryshëm eminentë nga fusha të ndryshme të drejtësisë, me peshë dhe rëndësi të veçantë për aktualitetet shoqërore. Do të jemi më aktiv në iniciativat e ndryshme ligjore me qasje kritike për të kontribuar që ato të jenë sa më të qëndrueshme dhe të arrijnë qëllimin e veprimit të tyre juridik;
- Organizimi i vizitave të studentëve në muzeun e kriminalistikës në Shkup, vizitë në Burgun e Idrizovës në Shkup, si dhe ndjekja e një seance të Parlamentit të Maqedonisë nga studentët tanë. Gjithashtu, realizohen vizita me studentët e gazetarisë në Tiranë dhe Prishtinë nëpër mediumet më prestigjioze, të shkruara,

radio dhe audio - vizuele: TVSH, RSH, ATSH, Top Channel, Tv Klan, RTK, TV 21, me qëllim të qasjes më të afërt të të ushtruarit të profesionit të gazetarit;

- Po ashtu, gjatë këtij viti, në dhjetor 2016, planifikohet organizmi i ***Ditëve të gjykimit të simuluar*** në Fakultetin Juridik në kuadër Universitetit “Goce Delçev”- Shtip, për herë të dytë, por kësaj radhe me karakter garues ndërmjet pesë universiteteve nga Maqedonia (UKIM, UKLO, UGD, UEJL dhe USHT);
- Në bashkëpunim me Institutin për të Drejtat e Njeriut në Shkup gjatë vitit 2016 u organizua trajnim treditör në gazetarinë hulumtuese në restorantin Bushi, ku studentët e Gazetarisë të shoqëruar nga profesori Doc. Dr. Dashmir Idrizi morën pjesë në këtë trajnim të ndarë në dy faza: teorike dhe praktike, në mes të ligjëruesve merrnin pjesë: Dr. Sc. Biljana Sekullovskaja, Mr. Snezhana Llupevska dhe përfaqësues të OSB-së;
- Kyçja e studentëve në projektet e ndryshme në bashkëpunim me komunat, ministrinë dhe ambasadat e huaja në vendin tonë;
- Vazhdimi i mbajtjes së seancave simuluese të gjykatës nga ana e studentëve, me ç’rast studentët do të mësohen me rregullat e zhvillimit të procedurave gjyqësore;
- Meqë nuk arritëm ta themelojmë një studio televizive të studentëve të USHT-së në vitin akademik që kaloi kjo do të mbetet po ashtu një nga qëllimet e realizimit të synimeve tona për këtë vit akademik. Në kuadër të departamentit të Gazetarisë kjo studio do të jetë në shërbim të të gjitha aktiviteteve të studentëve të Universitetit tonë;
- Vazhdimi i promovimit të të gjitha iniciativave të studentëve dhe dhënia e mundësive të barabarta për të gjithë ata, për një angazhim më aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv, në jetën e institucionit dhe në mësimnxënien e tyre.
- Studentët e Fakultetit Juridik të UT-së i fituan vendet e para në garat ndëruniversitare të organizuara nga Universiteti “Goce Dellçev” i Shtipit
- Gjatë vitit akademik 2017 - 2018 nën organizim të Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip u mbajtën garat për storien - kronikën më të mirë televizive. Në këto gara morën pjesë fakultetet e gazetarisë të tre Universiteteve: UKIM-Shkup, Goce

Dellçev-Shtip dhe USHT-Tetovë. Studentët tanë të katedrës së Gazetarisë, të shoqëruar nga profesori i tyre Doc. Dr. Dashmir Idrizi u prezantuan me storien filmim- kronikën televizive kushtuar rastit të 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë të vitit 2017, ku në shënjestër ishin edhe gazetarët dhe u shpërblyen me vendin e parë. Ekipit të studentëve u printe studenti Jakup Vejseli i shoqëruar nga Arlind Bajrami-kameraman dhe Egzon Misimi - montazher.

- Në garat ndëruniversitare, të cilat u organizuan në Universitetin “Goce Dellçev” në Shtip, me mbështetje të OSBE-së, për nder të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2018, me pjesëmarrjen e studentëve nga pesë fakultete juridike të universiteteve publike dhe private nga Maqedonia, studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës e fituan vendin e parë. Në këtë manifestim morën pjesë studentë nga fakultetet juridike të pesë universitete të ndryshme të vendit, si: Universiteti i Tetovës, Universiteti i Shkupit, Universiteti i Manastirit, Universiteti i Shtipit dhe Universiteti i Evropës Juglindore. Në këto gara, studentët garojnë mes veti për të marrë çmimin e parë përmes një gjykimi të simuluar, i cili vendoset në bazë të zgjidhjes së rastit. Studentët e Fakultetit Juridik në këto gara u udhëhoqën nga mentorët e këtij fakulteti Prof. Dr. Qebir Avziu dhe Doc. Dr. Arta Bilalli. Studentja e studimeve master në Fakultetin Juridik, Kaltrina Emro, u zgjodh si gjykatësja më e mirë, ndërsa edhe studentët e tjerë të grupit u vlerësuan maksimalisht për paraqitjet e tyre.
- Nën organizim të katedrës së Gazetarisë të Fakultetit Juridik pranë USHT-së me 30 tetor të vitit 2018 u organizua promovimi i librit “Fjalori politik i Berishës 90-92” i autorit Alfred Lela ligjërues në katedrën e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës.

### 3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

#### 3.1. Organogrami

Fakulteti Juridik ka këtë përbërje të dekanatit:

- Dekani;
- Prodekani për arsim;
- Prodekani për shkencë;
- Sekretari i Fakultetit;
- Shefi i programit të Studimeve të Drejtësisë;
- Shefi i programit të Shkencave Politike;
- Shefi i programit të Gazetarisë;
- Shefi i programit të Kriminalistikës;
- Koordinatori për studime pasdiplomike;
- Koordinatori për studime të doktoratës;
- Koordinatori për ECTS.

#### 3.2. Programet studimore në Fakultetin Juridik

##### *Studimet e Drejtësisë*

Në bazë të viteve të themelimit, programet studimore mund të paraqiten përmes tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1. Programet studimore në Fakultetin juridik sipas vitit të themelimit

|   | <b>Programi studimor</b> | <b>Viti i themelimi</b> |
|---|--------------------------|-------------------------|
| 1 | Studime të Drejtësisë    | 3+2                     |
| 2 | Shkencat Politike        | 4+1                     |
| 3 | Gazetari                 | 4+1, 3+2                |
| 4 | Kriminalistikë           | 3+0                     |

**Fakulteti Juridik**, si njësi akademike e arsimit të lartë, është i hapur për të gjithë studentët që dëshirojnë të studiojnë. Fakulteti Juridik organizon studime sipas modelit 3+2. Misioni i këtij Fakulteti është që juristët e ardhshëm që do të profesionalizohen në Fakultetin Juridik të jenë të aftë të marrin pozita dhe të zënë vende të punës në organet e jurisprudence, edhe atë në gjyqësi, prokurori publike, në avokaturë, në administratën shtetërore, në institucionet dhe organet e ndryshme të pushtetit shtetëror dhe në sektorin privat.

Ky Fakultet synon:

- Dijen, shkencën dhe arsimimin e brezave të rinj;
- Aftësimin e studentit të gjykojë në mënyrë kritike dhe të mendojë në mënyrë analitike;
- Aftësimin e studentit për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje apo politika të caktuara;
- Mundësia e studentit të shprehet lirshëm dhe të rezonojë në mënyrë më të gjerë.

Për realizimin e synimeve të lartpërmendura, Fakulteti Juridik ka akredituar programet studimore përkatëse, me:

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programit të studimit Shkencat Juridike në studimet e ciklit të parë në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 12-266 / 2-1 më datë 05.04.2013:

- Studime të Drejtësisë

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë të studimeve katërvjeçare në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 12-344 / 2, datë 17.01.2013:

- Studime Politike;
- Gazetaria dhe Media;
- Kriminalistikë.

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programit të studimeve të ciklit të parë të sistemit trevjeçar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 12-119 / 5, datë 17.09.2014.

- Vendimi për akreditimin e programeve studimore universitare në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Duke u bazuar në përmbajtjen e programeve studimore, mund të dallojmë këto karakteristika:

### ***Programi studimor Studimet e Drejtësisë***

- Në kuadër të programit studimor Studimet e Drejtësisë rreth 92% e lëndëve obligative janë në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Kualifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit. Një lëndë është pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas këtij klasifikimi. Sa i përket lëndëve zgjedhore rreth 83% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor, ndërsa 2 lëndë nuk janë aspak në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të lartpërmendur.
- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara janë plotësisht në përputhshmëri me kompetencat e definuara te deskriptorët në nivel të programit studimor, respektivisht qëllimi është orientimi i studentëve në njohjen e dukurive themelore që i ofrojnë lëndët në kuadër të këtij programi;
- Marrë në tërësi, vendosja kronologjike e lëndëve në kuadër të programit studimor Studimet e Drejtësisë relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve;
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në fushën e shkencës si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, të gjitha lëndët në kuadër programit studimor në Studimet e Drejtësisë kanë nevojë për azhurnim të pjesshëm.

### ***Programi studimor Gazetari***

Në kuadër të programit studimor Gazetari, 16 lëndë obligative (rreth 63%) janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Kualifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, si dhe 6 lëndë (37%) janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën këtij programi studimor. Prej 13 lëndëve zgjedhore rreth 46% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor, si dhe 7 lëndë (54%) janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e këtij programi studimor.

### ***Definimi i kompetencave në kuadër të programeve studimore***

- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara të lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me deskriptorët për zhvillim të kompetencave të programit studimor, respektivisht qëllimi është që studentët të orientohen drejt njohjes me dukuritë që i trajtojnë lëndët në kuadër të këtij programi studimor.
- Vendorsja kronologjike e lëndëve të programit studimor Gazetari relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathësive të studentëve.
- Aktivitetet me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të zhvillimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.

## **4. VEPRIMTARIA MËSIMORE - SHKENCORE**

Fakulteti Juridik realizon veprimtarinë edukativo–arsimore në harmoni me Sistemin e akumulimit dhe Transferimit të Kredive (ETCS) të akredituar në vitin 2012. Kohëzgjatja e studimeve në programet studimore të Fakultetit Juridik është e ndryshme. Gjegjësisht, programi

studimor i drejtësisë dhe i kriminalistikës zgjasin nga tre vjet me gjithsej 180 kredi (ECTS) të grumbulluara, ndërsa programi studimor i Shkencave Politike dhe Gazetarisë zgjasin katër vjet dhe studentët grumbullojnë gjithsej 240 kredi (ETCS). Tendenca e akreditimit të fundit të programeve studimore të Fakultetit Juridik është i orientuar nga implementimi i mirëfilltë i Sistemit të Bolonjës, me çka edhe plan-programet përmbajnë lëndë opsionale në vitet e caktuara studimore. Gjithashtu, në programin studimor të Shkencave Politike është bërë riakreditimi i plan-programit me tendencë të ndjekjes së trendeve bashkëkohore shkencore. Ky program është orientuar në mënyrë që t'i kushtohet kujdes edhe politikës sociale. Studentët procesin e studimeve e finalizojnë me përgatitjen e temës së diplomës. Numri i kredive ndryshon nga 2 e deri më 8. Karakteristikë e lëndëve opsionale është se bartin me vete 2 kredi, ndërsa për pjesën më të madhe të lëndëve karakteristikë është se kanë nga 5 kredi. Me qëllim të ndjekjes së nevojës së të rinjve për shkollim si dhe nevojës së tregut të punës, nga viti akademik 2013/2014, programi studimor i Shkencave Politike filloi me punë edhe në qytetin e Tetovës, ndërsa programi studimor i Studimeve të Drejtësisë hapi disperzime në qytetin e Kërçovës.

Tendenca e Fakultetit Juridik është që të jetë më pranë studentëve, duke i përgatitur si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik për të ushtruar veprimtarinë e tyre në të gjitha institucionet e sistemit juridik. Për këtë qëllim, në përputhshmëri me Ligjin për arsim të lartë dhe në përputhshmëri me sistemin për ECTS të Fakultetit Juridik dhe Statutin e Universitetit të Tetovës, nga viti akademik 2013/2014 filloi implementimi i planit aksional për realizimin e punës praktike në institucionet me të cilat Universiteti i Tetovës si dhe Fakulteti Juridik ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi. Studentët e programeve studimore të Studimeve të Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Kriminalistikës, praktikën e realizojnë në institucionet qendrore dhe rajonale të sistemit juridik, siç janë komunat, Gjykata Themelore, burgu i Tetovës si dhe njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë. Programi studimor i Gazetarisë, praktikën e realizon nëpër mediat e vendit, respektivisht në servisin publik TVM2, në TV nacionale, TV regjionale, gazetatat dhe radiot e vendit.

#### 4.1. Struktura e kuadrit mësimor–shkencor

Në Fakultetin Juridik procesin mësimor e realizojnë gjithsej 44 mësimdhënës, më konkretisht 28 mësimdhënës dhe 16 bashkëpunëtorë të rregullt. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit akademik në Fakultetin Juridik realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Stafi akademik i rregullt në Fakultetin Juridik është në moshë relativisht të re, si te bashkëpunëtorët, ashtu edhe te mësimdhënësit. Kjo paraqet një përparësi të madhe për studentët. Ata kanë mundësi të mësojnë nga përvojat e tyre bashkëkohore të zhvillimit të shkencës. Nga numri i përgjithshëm i stafit akademik në Fakultetin Juridik dominon gjinia mashkullore me rreth 75%, kurse gjinia femërore përfaqësohet me 25% të mësimdhënësve. Diskrepancë e madhe vërehet te mësimdhënësit: vetëm 16% prej tyre janë të gjinisë femërore, ndërsa ka tendenca të balancimit gjinor te bashkëpunëtorët, ku 42% janë të gjinisë femërore.

Nëse vërejmë proporcionin e stafit të rregullt në Fakultetin Juridik si dhe numrin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2015/2016 mund të shohim që numri i studentëve për “kokë” të profesorit është më i madh.

Tabelat më poshtë paraqesin pasqyrën e detajuar rreth titujve akademikë dhe moshës mesatare të të gjithë të angazhuarve.

Me qëllim që mësimdhënia të realizohet në mënyrë sa më efikase, në Fakultetin Juridik në vitin akademik 2015/2016 kanë qenë të angazhuar me kontratë 13 profesorë dhe 25 bashkëpunëtorë.

Tabela nr. 2 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2016/2017

| Rregullt  | Meshku<br>j | Femra | Mosha | Gjithsej | Me<br>kontra<br>të | Meshkuj | Femra | Mosha | Gjithsej |
|-----------|-------------|-------|-------|----------|--------------------|---------|-------|-------|----------|
| Ordinar   | 5           | /     | 60-65 | 1        | Ordina<br>r        | /       | /     | /     | /        |
| Inordinar | 2           | 1     | 45-55 | 3        | Inordin            | 1       | /     | 45-55 | 1        |

|                 |           |          |          |           |        |          |          |          |          |
|-----------------|-----------|----------|----------|-----------|--------|----------|----------|----------|----------|
|                 |           |          |          |           | ar     |          |          |          |          |
| Docent          | 15        | 5        | 33-45    | 20        | Docent | 8        | 0        | 30-60    |          |
| <b>Gjithsej</b> | <b>22</b> | <b>6</b> | <b>/</b> | <b>24</b> |        | <b>9</b> | <b>/</b> | <b>/</b> | <b>/</b> |

Tabela nr. 3 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2016/2017

| <b>Rregullt</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> | <b>Me kontratë</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> |
|-----------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|--------------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|
| Asistent        | 3              | 7            | 26-50        | 10              | Asistent           | 4              | 8            | 26-40        | 12              |
| <b>Gjithsej</b> | <b>3</b>       | <b>7</b>     | <b>/</b>     | <b>10</b>       | <b>Gjithsej</b>    | <b>4</b>       | <b>8</b>     | <b>/</b>     | <b>12</b>       |

Tabela nr. 4 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2017/2018

| <b>Rregullt</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> | <b>Me kontratë</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> |
|-----------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|--------------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|
| Ordinar         | 5              | 1            | 40-65        | 6               | Ordinar            | /              | /            | /            | /               |
| Inordinar       | 9              | 3            | 40-55        | 12              | Inordinar          | 2              | /            | 45-55        | 2               |
| Docent          | 8              | 3            | 33-55        | 20              | Docent             | 7              | 1            | 30-55        | 8               |
| <b>Gjithsej</b> | <b>22</b>      | <b>7</b>     | <b>/</b>     | <b>24</b>       |                    | <b>9</b>       | <b>1</b>     | <b>/</b>     | <b>/</b>        |

Tabela nr. 5 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2017/2018

| <b>Rregullt</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> | <b>Me kontratë</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> | <b>Mosha</b> | <b>Gjithsej</b> |
|-----------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|--------------------|----------------|--------------|--------------|-----------------|
| Asistent        | 3              | 7            | 26-50        | 10              | Asistent           | 10             | 10           | 26-40        | 20              |
| <b>Gjithsej</b> | <b>3</b>       | <b>7</b>     | <b>/</b>     | <b>10</b>       | <b>Gjithsej</b>    | <b>10</b>      | <b>10</b>    | <b>/</b>     | <b>12</b>       |

Tabela nr. 6 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2018/2019

| Rregullt        | Meshkuj   | Femra    | Mosha    | Gjithsej  | Me kontratë | Meshkuj  | Femra    | Mosha    | Gjithsej  |
|-----------------|-----------|----------|----------|-----------|-------------|----------|----------|----------|-----------|
| Ordinar         | 5         | 1        | 40-65    | 6         | Ordinar     | /        | /        | /        | /         |
| Inordinar       | 9         | 3        | 40-55    | 12        | Inordinar   | 2        | /        | 35-42    | 2         |
| Docent          | 7         | 5        | 33-55    | 12        | Docent      | 7        | 1        | 31-57    | 8         |
| <b>Gjithsej</b> | <b>21</b> | <b>9</b> | <b>/</b> | <b>30</b> |             | <b>9</b> | <b>1</b> | <b>/</b> | <b>10</b> |

Tabela nr. 7 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2018/2019

| Rregullt        | Meshkuj  | Femra    | Mosha    | Gjithsej | Me kontratë     | Meshkuj  | Femra    | Mosha    | Gjithsej |
|-----------------|----------|----------|----------|----------|-----------------|----------|----------|----------|----------|
| Asistent        | 3        | 5        | 41/60    | 8        | Asistent        | 2        | 5        | 28/37    | 7        |
| <b>Gjithsej</b> | <b>3</b> | <b>5</b> | <b>/</b> | <b>8</b> | <b>Gjithsej</b> | <b>2</b> | <b>5</b> | <b>/</b> | <b>7</b> |

## 5. STRUKTURA E STUDENTËVE

### 5.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Fakulteti Juridik prezantohet para studentëve të ardhshëm në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Ky proces realizohet përmes vizitave nëpër shkolla të mesme në Republikën e Maqedonisë, por edhe përmes organizimit të ditës së hapur. Gjatë këtyre vizitave prezantohet fakulteti, përfshirë edhe programet studimore në veçanti, karakteristikat e tyre, si dhe kushtet të cilat i posedon për realizimin e plan-programeve të cilat i ofron. Pos tjerash promovimi i Fakultetit Juridik realizohet edhe në kuadër të ditëve të hapura që mbahen në hapësirat e Universitetit, me çka ofrohen materiale të ndryshme promovuese, përmes të cilave u ofrohet mundësi studentëve të ardhshëm që të njihen me stafin dhe të njihen me hapësirat ku do të realizohet mësimdhënia.

Tabela nr. 8 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2016/2017

|   | Programi studimor     | Rregullt   |           | Korrespondencë |           | Projekt 35-45 |          | Gjithsej   | Shtetas të huaj |          | Nacionaliteti |          |
|---|-----------------------|------------|-----------|----------------|-----------|---------------|----------|------------|-----------------|----------|---------------|----------|
|   |                       | M          | F         | M              | F         | M             | F        |            | M               | F        | M             | F        |
| 1 | Studime të Drejtësisë | 37         | 46        | 23             | 10        | 10            | 6        | 132        | 4               | 1        | /             | 3        |
| 2 | Shkencat Politike     | 16         | 2         | /              | /         | /             | /        | 18         | 2               | /        | /             | /        |
| 3 | Gazetari              | 6          | 2         | /              | /         | /             | /        | 8          | /               | /        | /             | /        |
| 4 | Kriminalistikë        | 63         | 7         | /              | /         | /             | /        | 70         | /               | /        | 3             | 1        |
|   | <b>Gjithsej</b>       | <b>122</b> | <b>57</b> | <b>23</b>      | <b>10</b> | <b>10</b>     | <b>6</b> | <b>218</b> | <b>6</b>        | <b>1</b> | <b>9</b>      | <b>4</b> |

Tabela nr. 9 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2017/2018

|   | Programi studimor     | Rregullt  |           | Korrespondencë |          | Projekt 35-45 |          | Gjithsej   | Shtetas të huaj |          | Nacionaliteti |          |
|---|-----------------------|-----------|-----------|----------------|----------|---------------|----------|------------|-----------------|----------|---------------|----------|
|   |                       | M         | F         | M              | F        | M             | F        |            | M               | F        | M             | F        |
| 1 | Studime të Drejtësisë | 30        | 30        | 23             | 9        | /             | /        | 92         | /               | /        | /             | /        |
| 2 | Shkencat Politike     | 13        | 8         | /              | /        | /             | /        | 21         | /               | 2        | /             | /        |
| 3 | Gazetari              | 1         | 7         | /              | /        | /             | /        | 8          | /               | /        | /             | /        |
| 4 | Kriminalistikë        | 51        | 4         | /              | /        | /             | /        | 55         | /               | /        | 1             | /        |
|   | <b>Gjithsej</b>       | <b>95</b> | <b>49</b> | <b>23</b>      | <b>9</b> | <b>/</b>      | <b>/</b> | <b>176</b> | <b>/</b>        | <b>2</b> | <b>/</b>      | <b>/</b> |

Tabela nr. 10 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2018/2019

|   | Programi studimor     | Rregullt  |           | Korrespondencë |           | Projekt 35-45 |          | Gjithsej   | Shtetas të huaj |          | Nacionaliteti |          |
|---|-----------------------|-----------|-----------|----------------|-----------|---------------|----------|------------|-----------------|----------|---------------|----------|
|   |                       | M         | F         | M              | F         | M             | F        |            | M               | F        | M             | F        |
| 1 | Studime të Drejtësisë | 20        | 33        | 14             | 11        | /             | /        | 78         | 1               | 6        | /             | 1        |
| 2 | Shkencat Politike     | 4         | 2         | /              | /         | /             | /        | 6          | 1               | /        | /             | /        |
| 3 | Gazetari              | 4         | 2         | /              | /         | /             | /        | 6          | /               | 1        | /             | /        |
| 4 | Kriminalistikë        | 44        | 5         | /              | /         | /             | /        | 49         | 1               | /        | /             | /        |
